

**ON SOLUTIONS SH.P.K**  
**RRUGA SHKËLQIM FUSHA, PALLATI 'MATRIX KONSTRUKSION', KATI +1, TIRANË**  
**NUIS: M02219018E**

---

Sot, më datë 27.01.2021 (dymijë e njëzetë e një), në selinë e Shoqërisë "ON SOLUTIONS" Sh.p.k. me NUIS M02219018E (më tej referuar si "**Shoqëria**"), në adresën "Rruga Shkëlqim Fusha, Pallati 'Matrix Konstruksion', Kati +1, Tiranë" u paraqitën palët e mëposhtme ortake të Shoqërisë:

- **Shoqëria "Balfin-Balkan Finance Investment Group" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NIPT/NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 12, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë (më tej referuar si "Ortaku i Vetëm"), e përfaqësuar ligjërisht nga **znj. Edlira Muka** në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k.;
- **Znj. Ada Gramatiku** në cilësinë e konsulentit ligjor të shoqërisë Balfin Sh.p.k.;

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Bers Hado, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

- I. **MIRATIMI I ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË MËPOSHTME.**
- II. **TE NDRYSHME.**

I. **MIRATIMI I ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË MËPOSHTME.**

Kryetari i Asamblesë, në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, parashtroi se Ortaku i Vetëm ka kontribuar në para në Shoqëri në një vlerë totale prej 60,000 Euro (gjashtëdhjetë mijë euro) ose 7,417,200 Lekë (shtatë milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind lekë).<sup>1</sup> Duke qënë se kërkohet kapitalizimi i kontributeve të dhëna nga Ortaku, lind nevoja për miratimin e rritjes së kapitalit nëpërmjet kontributit në para të Ortakut të Vetëm me një vlerë të përgjithshme prej **7,417,200 Lekë (shtatë milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind lekë) ('Zmadhimi i Kapitalit')**. Zmadhimi i kapitalit është shlyer plotësisht në datë 05.01.2021, në llogarinë e Shoqërisë.

---

<sup>1</sup> 60,000 Euro janë konvertuar në vlerën prej 7,417,200 leke, sipas kursit të këmbimit 123.62, të Bankes së Shqipërisë të datës 05.01.2021.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë të Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme me unanimitet:

\* \* \* \* \*

**VENDOSI:**

- A. Të miratojë Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej 7,417,200 Lekë (shtatë milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind lekë).
- B. Zmadhimi i Kapitalit është shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm në datën 05.01.2021.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave A dhe B më sipër, kapitali i Shoqërisë, nga 100 Lekë (njëqind lekë) do të bëhet **7,417,300 Lekë (shtatë milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind lekë)**.
- D. Të autorizojë Z. Dimitrios Vratimos, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të On Solutions Sh.p.k., për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ('QKB'), ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për këto veprime.


\* \* \* \* \*

Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për tu shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.


**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE E SHOQËRISË**

**"On Solution" SH.P.K.**

**KRYETARI**

  
Znj. Edlira MUKA  
Balfin Sh.p.k

**SEKRETARI**

  
Z. Bers Hado

**BALFIN**  
Balkan Finance Investment Group